VENDIM
Nr. 61, datë 24.2.2000

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RISTRUKTURIMIT DHE TË PËRGATITJES PËR PRIVATIZIM TË SHOQËRISË ANONIME "INSTITUTI I SIGURIMEVE"

(Ndryshuar me VKM nr. 452, datë 17.8.2000)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, 12 dhe 14, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", me propozimin e e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e programit të ristrukturimit dhe të përgatitjes për privatizim të shoqërisë anonime "Instituti i Sigurimeve", që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim fillimin e procedurave ligjore të privatizimit të kësaj shoqërie në vitin 2001.
2. Ngarkohet ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PROGRAMI I RISTRUKTURIMIT DHE PËRGATITJES PËR PRIVATIZIM TË SHOQËRISË ANONIME "INSTITUTI I SIGURIMEVE"

Programi i ristrukturimit dhe privatizimittë INSIG sh.a. parashikon një sërë masash dhe veprimesh, të ndarë në dy faza:

Faza e parë:

Ristrukturimi tekniko-administrativ dhe ekonomiko-financiar nga degët deri në zyrat qendrore.

Kjo fazë është e ndarë në dy etapa dhe do të përfshijë:

Etapën e parë:

a. Shitjen e të gjitha llojeve të produkteve të sigurimit nëpërmjet agjensive të sigurimit me të cilat janë lidhur dhe do të lidhen kontrata eskluzive agjensie, pa hequr dorë nga shitja në degët tona të sigurimeve.

b. Shndërrimin brenda 3- mujorit të parë të vitit 2000 të pikave të shitjes në disa degë kryesore si Tirana e ndonjë tjeter në agjentë me shpërblim në bazë komisioni.

c. Kalimin e disa degëve të vogla, të cilat janë jo efektive (pasi dalin me humbje) dhe kanë aktivitet të vogël e shpenzime të mëdha, në agjensi sigurimesh brenda 3-mujorit të parë të vitit 2000.

d. Degët e sigurimeve që janë efektive *dhe joefektive* nuk do të kenë më si funksion kryesor vetëm shitjen direkte të produkteve. Një pjesë e punonjësve do të kalojnë në agjentë eskluzivë të INSIG-ut. Fillimisht, atyre, për një periudhë kohe (3 deri në 6 muaj) do t'u krijohen kushte lehtësuese si: ambiente pune (zyra dhe pajisje), fillimisht pa pagesë dhe pas 6 muajve kundrejt pagimit të një qeraje, si edhe një pagë e garantuar në masën jo më pak se 50% gjatë kësaj periudhe 6 mujore.

Etapa e dytë:

Gjatë kësaj etape do të merren masa që mbajnë parasysh riorganizimin dhe ristrukturimin

e INSIG sh.a. për t'ju përgjigjur sa më mirë kushteve të reja të tregut të sigurimeve dhe pa i lejuar vetes kufizimin apo humbjen e tregut të sigurimeve, siç janë:

Krijimi i nje strukture shumë më të manovrueshme dhe të shpejtë në vendimarrje në zyrat qendrore te INSIG–ut në bazë të një studimi të përgatitur mirë dhe të diskutuar gjerësisht me Drejtorët e Drejtorive dhe Këshillin Drejtues, me synim thjeshtësimin e strukturës dhe rritjen e efektivitetit të INSIG sh.a. në kushtet e reja të tregut.

Ky ristrukturim duhet të përfundojë brenda 6- mujorit të parë të vitit 2000.

Këto masa janë bërë të domosdoshme mbasi në raport me vëllimin e biznesit numri i punonjësve ne zyrat qendrore është i lartë, çka vështirëson deri në pamundësi koordinimin midis drejtorive dhe sektorëve duke krijuar shpesh dublime të panevojshme Gjithashtu numri i madh i hallkave krijon shpesh konfuzion në marrëdhëniet me degët e sigurimeve dhe klientat e mëdhenj e të mësëm qe kanë nevojë për sigurime komplekse.

Ristrukturimi në zyrat qendrore do të realizohet me kritere të shëndosha tekniko-organizative nëpërmjet bashkimeve funksionale të disa drejtorive, shkrirjes së disa të tjerave, transformimit të disa prej tyre nga drejtori në zyra ose byro, duke shmangur në cdo rast bashkimet thjesht mekanike, por duke iu permbajtur përafërsisë teknologjike.

Ky proces pritet të sjellë një reduktim të numrit aktual të punonjësve në zyrat qendrore por pa krijuar brenda mundësive shqetësime sociale akute.

Natyrisht, organigrama dhe organika mbasi të diskutohen në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në Këshillin Mbikqyrës do t'i paraqiten për miratim Ministrit të Financave, si aksioneri kryesor dhe i vetëm i INSIG sh.a.

Për sa i përket punonjësve që do të reduktohen nga ristrukturimi i kompanisë në zyrat qendrore *dhe në degët në rrethe* ka dy alternativa për të zgjidhur anën sociale të problemit:

- atyre mund t'u ofrohet një kontratë agjensie për të shitur produktet e INSIG-ut, duke i dhënë për një periudhë kohe 6- mujore një shpërblim fiks në masën 50% të pagës,
- atyre që nuk do të pranonin zgjidhjen e mësipërme do t'u jepet paga e plotë për një periudhë një vjeçare dhe 50 % e pagës për gjashtë muajt e parë të vitit pasardhës.

Faza e dytë:

Përgatitja e kushteve për privatizimin e kompanisë, proces ky që kërkon mbështetje efektive në këto drejtime kryesore:

a. Asistencë teknike të Bankës Botërore për përgatitjen e kuadrit ligjor për fillimin e këtij procesi deri në fund të vitit 2000.

b. Auditim të kompanisë me asistencën e donatorëve të huaj, brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2000.

c. Përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të formulës së privatizimit, të ligjit përkatës dhe të akteve të tjera nënligjore për privatizimin deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2001.

Gjatë fazës së ristrukturimit dhe përgatitjes për privatizim, INSIG-u do të marrë dhe zbatojë disa masa efektive siç janë:

1. Krijimi i një pozicioni aktiv ndaj klientëve në treg, nëpërmjet zbatimit të një sistemi shitjeje me bazë komerciale, duke shfrytëzuar infrastrukturën e ngritur gjë e cila nuk kërkon asnjë lloj investimi paraprak, si edhe duke u dhenë degëve funksione prioritare marketingu. Në ndryshimin e këtij pozicioni, rol jo të vogël do të luajë zbatimi i një marketingu agresiv sidomos në kushtet e konkurencës.

2. Përmirësimi rrënjësor i cilësisë së shërbimit ndaj klientëve, nëpërmjet përmirësimit të skemave të administrimit të dëmshpërblimeve, ofrimit të një game të gjerë të produkteve dhe shërbimeve, zbatimit të formave të reja të komunikimit me klientët në bazë të një kodi etik e profesional.

3. Nxitja e motivimit profesional nëpërmjet vlerësimit analitik të vendeve të punës (job descriptions), zbatimit të një programi trajnues në përputhje me objektivat e kompanisë, si edhe i përdorimit me efikasitet të sistemit ekzistues të shpërblimeve e lidhur ngushtë kjo me kontributin

profesional të gjithësecilit.

4. Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve nëpërmjet diversifikimit të mëtejshëm të portofolit të depozitave bankare, shfrytëzimit të mundësive në projekte të përbashkëta investuese, investimeve në tregun e pasurive të paluajtshme , si troje, ndertesa, etj.

5. Vendosja e një sistemi informacioni modern nëpërmjët rinovimit të hardware, vendosjes së postës elektronike, lidhjes me internet si edhe përgatitjes për blerjen e software.